



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA POGRADEC

**SHPLLJE PËR NËPUNËS CIVIL PËR LËVIZJE PARALELE  
DHE PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL NË KATEGORINË  
EKZEKUTIVE**

**Pogradec më 17 / 06 / 2019**

Në zbatim të nenit 22 dhe të nenit 25, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, të Vendimit Nr. 243, datë 18/03/2015, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” të Këshillit të Ministrave, Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore pranë Bashkisë Pogradec shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive, për pozicionet:

**1 (Një) Pozicion –Përgjegjës i Sektorit të Shërbimit Pyjor ,Kategori e pagës III-b.**

**3(Tre) Pozicione- Specialist për pyjet dhe kullotat, Kategori e pagës IV-a.**

Pozicioni më sipër, u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.

Për të gjitha procedurat (lëvizje paralele, ngritje në detyrë) aplikohet në të njëjtën kohë!

Afati për dorëzimin e dokumentave për LEVIZJE PARALELE: 27 Qershor 2019

Afati për dorëzimin e dokumentave për PRANIM NE SHERBIMIN CIVIL: 2 Korrik 2019

- **Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin Përgjegjës i Sektorit të Shërbimit Pyjor:**

- Organizon dhe planifikon planet e veprimit për zhvillimin e pyjeve dhe kullotave nën juridiksionin administrativ të Bashkisë.
- Organizon dhe drejton punën për trajtimin dhe shfrytëzimin e fondit pyjor bashkiak mbi bazën e Planeve të Menaxhimit dhe Inventarizimit të pyjeve.
- Kontrollon realizimin e planit të të ardhurave nga lëndët drusore.



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA POGRADEC

- Përgjegjës për përmbushjen e detyrave sipas planit vjetor dhe mujor .
  - Planifikon dhe përmbush detyrat e ngarkuara në mënyrë profesionale dhe të pavarur .
  - Identifikon mundësitë për përmirësimin e mëtejshëm të procedurave dhe teknikave të përdorura në përmbushjen e detyrave.
  - Përgjegjës për korrigjimin e çdo shmangieje të konsiderueshme që mund të ekzistojë mes objektivave dhe rezultatit faktiv.
  - Përgjigjet për zbatimin e rregullave për organizimin e brendshëm të punës dhe të procedurave administrative.
  - Organizon ,drejton koordinon dhe kontrollon punën e drejtorisë, sektorit ,specialistëve dhe punonjësve që janë nën autoritetin e tij.
- **Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin Specialist për pyjet dhe kullotat:**
    - Organizon ,planifikon aktivitetet që lidhen me qeverisjen ,shtimin e pyjeve dhe rritjen e prodhimtarisë së tyre ,trajton në aspektin shkencor mbarështimin e qëndrueshëm e afatgjatë të pyjeve/kullotave në përputhje me objektivat e politikave dhe strategjisë së pyjeve.
    - Veprimtaria e specialistit të pyjeve gjatë punës duhet të jetë gjithmonë në pajtueshmëri të plotë me ligjislacionin e pyjeve dhe kullotave dhe kodin administrativ në Republikën e Shqipërisë.
    - Harton projekte dhe preventiva punimesh në pyje dhe kullota sipas Eprorit direkt dhe në përputhje me legjislacionin.
    - Harton raporte teknike të ndryshme në përputhje me kërkesat.
    - Harton programe masash për mbrojtjen e pyjeve nga zjarri dhe mbron dëmtimet e paligjshme.



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA POGRADEC

- Harton planet e punës mujore dhe aktivitetet vjetore .
- Bashkëpunon me specialistët e zonave për realizimin e detyrave dhe realizimin e të ardhurave sipas planit të miratuar nga drejtoria e pyjeve.
- Ndjek të gjitha veprimtaritë shfrytëzimit të lëndëve drusore dhe shfrytëzimit të lëndëve minerare që kryhen brenda fondit pyjor dhe atij të kullotave në juridiksionin e bashkisë në përputhje me legjislacionin.
- Angazhon fondin pyjor dhe kullusor nëpërmjet mbajtjes së të dënave ,pasqyrimin e ndryshimeve dhe mbylljen e kadastrës pyjore/kullusore vjetore, bazuar në metodikën e përcaktuar nga Ministria e Mjedisit.
- Ofron shërbimin këshëllimor dhe jep asistencë teknike për pronarët dhe përdoruesit e pyjeve dhe kullotave ,organizon komunikimin dhe informimin për pjesëmarrjen publike në sektorin e pyjeve dhe kullotave dhe merr pjesë në sensibilizimin dhe edukimin e përgjithshëm mjedisor të publikut.

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

### **1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA**

**Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:**

- a. Të jenë nëpunës civilë të konfirmuar, brenda kategorisë III-b ;
- b. Të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
- c. Të kenë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”.

**Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:**

- a. Të zotërojnë diplomë të nivelit "Master Shkencor".
- b. Edhe diploma e nivelit Bachelor të jetë në të njëjtën fushë.

### **1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**

<sup>1</sup>Bulevardi "Rreshit Çollaku", Lagja: Nr.2, Tel: +355 (83) 222222, Fax: +355 (83) 222441, E-mail: [bashkiapogradec@gmail.com](mailto:bashkiapogradec@gmail.com)



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA POGRADEC

### **Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë**

- a- Jetëshkrim i aplikantit;
- b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e- Vërtetim të gjendjes shëndetësore
- f- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore.
- g- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka mase disiplinore në fuqi.
- i- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton dokumentet e përmendura në jetëshkrimin tuaj;

### **1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK**

Në datën 23 Qershor 2019 Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore do të shpallë në faqen zyrtare të internetit dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e lëvizjes paralele, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë kur do të zhvillohet intervista. Në të njëjtën datë kandidatët që nuk plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kërkesat e posaçme do të njoftohen individualisht nga Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

### **1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA**

#### **-Kandidatët për pozicionet më sipër do të vlerësohen në lidhje me:**

- 1.Ligji nr .139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”
- 2.Ligji për “Shpalljen e Moratoriumit të Fondit të Pyjor në Republikën e Shqipërisë”
- 3.Ligji për “Administrimin e Fondit Pyjor dhe Kullusor Kombëtar në Republikën e Shqipërisë”
- 4.Ligji nr.9385 datë 04.05.2005”Për pyjet dhe shërbimin pyjor”
- 5.Ligji nr. 68/2014 për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9587, datë 20.07.2006 “Për mbrojtjen e diversitetit” të ndryshuar.
- 6.Ligji nr.152/2013 “Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar
- 7.Ligji nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”

### **1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE**

#### **Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:**

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe çertifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë në rastet kur procesi i çertifikimit nuk është kryer. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

#### **Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:**

<sup>1</sup>Bulevardi "Rreshit Çollaku", Lagja: Nr.2, Tel: +355 (83) 222222, Fax: +355 (83) 222441, E-mail: [bashkiapogradec@gmail.com](mailto:bashkiapogradec@gmail.com)



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA POGRADEC

a - Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;

b - Eksperiencën e tyre të mëparshme;

c - Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën;

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë.

### 1.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore e Bashkisë Pogradec do të shpallë fituesin në faqen zyrtare dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga NJMBNJ, për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

## 2. PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL NË KATEGORINË EKZEKUTIVE

Vetëm në rast se nga pozicionet e renditura në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicione vakante, këto pozicione janë të vlefshme për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

### 2.1 KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NE SHËRBIMIN CIVIL DHE KRITERET E VEÇANTA

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

#### **Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil janë:**

- a- Të jetë shtetas shqiptar;
- b- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- f- Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

#### **Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:**

<sup>1</sup>Bulevardi "Rreshit Çollaku", Lagja: Nr.2, Tel: +355 (83) 222222, Fax: +355 (83) 222441, E-mail: [bashkiapogradec@gmail.com](mailto:bashkiapogradec@gmail.com)



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA POGRADEC**

a. Të ketë arsim të lartë të nivelit Bachelor.

**2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i aplikantit;
- b- Fotokopje të diplomës ;
- c- Fotokopje e dëshmisë së gjuhës së huaj
- d- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- e- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- f- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- g- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore.
- h- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

**2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK**

Në 28 Qershor 2019 Njësia e Menaxhimit të burimeve Njerëzore do të shpallë në faqen zyrtare të internetit dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme.

**2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA**

**Kandidatët do të testohen me shkrim për njohuritë mbi dokumentet e listuara në pikën 1.4**

**Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:**

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

**2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE PËR PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL**

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Vlerësimin me shkrim, deri në 60 pikë;
- b- Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 25 pikë;
- c- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 15 pikë.

**2.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve , Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore do të shpallë fituesin në stendat e informimit të publikut, në faqen zyrtare të Bashkisë Pogradec dhe në

<sup>1</sup>Bulevardi "Rreshit Çollaku", Lagja: Nr.2, Tel: +355 (83) 222222, Fax: +355 (83) 222441, E-mail: [bashkiapogradec@gmail.com](mailto:bashkiapogradec@gmail.com)



---

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA POGRADEC**

portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, për rezultatet nëpërmjet (adresës së e-mail). Brenda tre ditëve kalendarike nga njoftimi individët kanë të drejtë të paraqesin ankesa me shkrim pranë zyrës së Burimeve Njerëzore.

**NJËSIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE**

MAJLINDA ÇUNI

PRANVERA SHKULLAKU

ALBANA BERBERI